VENDIM
Nr. 26, datë 11.2.2015

PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË APLIKIMIT PËR LICENCË NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", nenit 8 pika 2 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë dhe të pjesshëm dhe rinovimit të licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin nr. 9, datë 11.2.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore Administrim-Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit mbi përcaktimin e pagesës së aplikimit për licencë në sektorin e gazit natyror dhe konsideroi të drejtë interpretimin e Drejtorive,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e pagesës së aplikimit për licencë në aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit në sektorin e gazit natyror, të njëjtë me pagesat e aplikimit të të licencuarve në aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit në sektorin e energjisë elektrike siç janë përcaktuar në aneksin A të "Rregullore për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë dhe të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", miratuar me vendimin nr. 108 datë 9.9.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti